



www.teatrioda.com

Teatri ODA Për të rinj - Grupet e përhershme për fëmijë

Teatri ODA pas një periudhe të gjatë të punës me dhe për të rinj ka filluar një fazë të re të punës dedikuar fëmijëve dhe të rinjve. Duke filluar nga 1 tetori do të organizohen grupe të përhershme me punëtorin të rregullta javore të cilat do të prodhojnë shfaqjen në fund të sezonit përkatësisht në muajin qershor në Teatrin ODA në Prishtinë.

Kujt i dedikohet?

Grupet janë të dedikuara për fëmijë të moshës **8 deri 11 vjeç** dhe **11 deri 14 vjeç**. Dy grupet do të jetë të përbëra prej të gjitha moshave brenda këtyre kufizave. Puna që zhvillohet në grupe i dedikohet të gjithë fëmijëve pa përjashtim dhe pavarësisht talentit që ata mund të kenë për arte skenike apo arte tjera. Përmes lojërave teatrore që praktikohen fëmijët duke punuar bashkërisht zhvillojnë aftësi të reja sociale e psikologjike, zhvillojnë shumë edhe kreativitetin, aftësitë për zgjidhje problemesh, aftësitë komunikuese, forcim të vetëbesimit dhe mbi të gjitha kalojnë nëpër një eksperiencë të këndshme grupore dhe përvojë ekzaltuese të shfaqjes para publikut.

Ku dhe kur?

Grupet fillojnë punën nga 1 tetori dhe përfundojnë në javën e fundit të qershorit kur edhe parashihet shfaqja e grupit. Punëtoritë mbahen rregullisht 2 herë në javë, për fëmijët që janë në mësim paradite prej orës 14 - 15:30 , ndërsa për ata që janë në mësim pasdite prej orës 11 - 12:30 (me një pauzë të vogël mes dy sesioneve). Ditët do të përcaktohen me krijimin e grupeve dhe konsultimet me prindërit për ditët e përshtatshme.

Në bazë të kërkesave mund të krijohen edhe grupe tjera në kohë tjetër nga këto e edhe për moshat tjera jashtë këtyre kufizave.

Grupet do të punojnë në hapësirat e Teatrit ODA, Pallati i Rinisë, 111, Prishtinë (hyrja prej parkingut nga ana e Stadiumit të qytetit). Grupet do të udhëhiqen nga profesionistë të kësaj fushe: Ilire Vinca, Florent Mehmeti, Vjosa Malokaj dhe Doresa Rexha.

Çka dhe si punohet në grupe?

Puna e grupeve është e konceptuar si kohë e fëmijëve të cilën ata e kalojnë si lojë e përfitimet janë shumë të mëdha. Përderisa pjesëmarrja në grup është një eksperiencë e lojës grupore shumë të këndshme nuk përjetohet si punë. Kjo e bën përvojën e fëmijëve me përfitime të shumëfishta. Teknikat që përdoren janë teknikat e lojërave të teatrit të cilat janë të kategorizuara sipas rezultatit. Lojërat të

caktuara zhvillojnë aftësi të caktuara. Puna e grupeve është e drejtuar dhe e konceptuar shumë më shumë në proces sesa në rezultatin final, shfaqjen e prodhuar nga grupi. Shfaqja e prodhuar nga grupi në fund është më shumë një prezantim i të arriturave të fëmijëve dhe grupit në tërësi.

Kjo përvojë është me të vërtetë unike për fëmijët. Në vend se t'i ngjasojë një krijimi artistik të formës klasike që shumë shpesh si proces është tepër i rëndë e i ndërlikuar edhe për profesionistë me shumë përvojë, është më shumë një përvojë që për fokus ka secilin fëmijë individualisht duke e udhëhequr atë drejt zhvillimit të tij apo saj si personalitet që ka siguri më të madhe kur shprehet, kur prezanton diçka para publikut apo arsimtarit, që përforcon qëndrimet dhe mendimet e tij personale, krijon shoqëri më lehtë, është më kreativ në zgjidhje problemesh dhe në përgjithësi është më i ndërtuar si personalitet. Sa herë kemi menduar ne si prindër se çka duhet t'ju ofrojmë fëmijëve që të zhvillohen sa më mirë e të bëhen të gatshëm për jetën? Sa herë i kemi bërë pyetje vetes si të komunikojmë me ta, si të zgjidhim problemet e më të dashurve, si të futemi në botën e tyre e t'i kuptojmë më mirë, si të rrisim vetëbesimin e tyre, si t'i socializojmë, ashtu që ata të duan veten, rrethin dhe të ndjehen të vlefshëm?

Bota e fëmijëve e mbushur me fantazi e me imagjinatë do ketë më në fund mundësi të shfaqet, larg obligimeve, larg detyrave, larg çdo ngarkese nëpër të cilën kalojnë në përditshmëri. Krijimi i një ambienti të tillë, ku ideja e secilit çmohet, ku mendimi nuk paragjykohet dhe përfshirja e secilit në mënyrë të barabartë do të ndikojë te fëmija në mënyrë fantastike.

Fëmijët që kanë probleme të koncentrimin në mësim, që janë të mbyllur, që kanë vetëbesim të ulët, që vështirë shoqërohen apo edhe probleme tjera të aspekteve shoqërore e psikologjike janë të inkurajuar veçanërisht që të marrin pjesë për përfitime të shumta dhe bukur të shpejta.

Grupi i krijuar në sesionet e para do të emërtojë grupin me një emër që do të jetë i afërt për të gjithë dhe do të vazhdojë punën me atë emër. Përderisa është me rëndësi procesi dhe përvoja përmes sesioneve do të identifikohet edhe tema apo temat që grupi dëshiroj t'i trajtojë në shfaqjen që do të prodhohet. Kjo mënyrë, edhe pse jo e lehtë derisa të arrihet kompaktësia e grupit, sjell një benefit shumë të madh, i jep një hapësirë fëmijëve të shprehin publikisht dhe në formë interesante artistike preokupimet e tyre dhe ndjenja e pronësisë së shfaqjes në fund është shumë e fortë dhe shumë nxitëse për secilin fëmijë. Përderisa gjatë gjithë vitit shkollor punohet në ndërtimin e shfaqjes, do të përgatiten edhe prezantime publike të shkurtra në disa faza të punës. Grupi do të paraqes prezantime 5-10 minutëshe para prindërve dhe të ftuarve të tjerë përafërsisht pas çdo 2-3 muaj të punës.

Kjo metodologji e punës e veçantë dhe unike, sidomos në Kosovë, ofrohet nga Teatri ODA për fëmijët bazuar në trajnime e ekspertizë të edukatorëve të përfituara nga bashkëpunimi me Nottingham Playhouse të Britanisë së Madhe në bashkëpunim me Këshillin Britanik (British Council) si dhe përvoja tashmë e punës me shumë grupe të rinjsh që kanë kaluar përvoja të tilla në Teatrin ODA si dhe me 20 klube teatrore me gjithsej 400 fëmijë nëpër shkollat fillore të Kosovës të cilat i ka themeluar Teatri ODA.

Si të regjistrohemi?

Vendet për pjesëmarrje ndahen bazuar në pranimin e aplikimeve, numri do të plotësohet me aplikimet e para. Për të siguruar pjesëmarrjen tuaj në Grupet e Përhershme për Fëmijë të Teatrit ODA, ju duhet të aplikoni sa më shpejtë që të mundeni. Mbushni formën e aplikimit dhe dërgojeni në email: info@teatrioda.com dhe teatrioda@gmail.com apo fizikisht në Teatrin ODA, Pallati i Rinisë, 111, Prishtinë çdo ditë pune prej orës 08:00 deri 23:00.

Pjesëmarrja në grupe është me pagesë prej 30 euro për gjithsej 16 sesione që mbahen për 8 ditë brenda muajit.

Për pjesëmarrësit që duan ta paguajnë të gjithë sezonin (9 muaj: Nëntor2014 - Qershor2015) aplikohet 20% lirim dhe pagesa për muaj është 24 euro.

Për fëmijët e të njëjtës familje, për fëmijën e dytë aplikohet 20% zbritje dhe fëmijën e tretë 30% zbritje.

Për fëmijët që dëshirojnë të marrin pjesë por për shkak të gjendjes sociale nuk janë në mundësi të paguajnë, prindërit duhet të kontaktojnë Valon Ibraj në Teatrin ODA për të sjellë dëshmitë e gjendjes sociale.

Cështje tjera që duhet t'i dini

- Grupet e Përhershme për Fëmijë të Teatrit ODA nuk janë për ata që janë nën moshën 8 vjeçare apo më të vjetër se 14 vjeç. Për këto grupmosha do të ketë në të ardhmen grupe të tjera për të cilat do t'ju informojmë me kohë.
- Neve na duhet të kemi **pajtim me shkrim** për pjesëmarrje nga prindërit apo kujdestari për të fëmijët. Forma e pajtimit të prindit/kujdestarit mund të merret në Teatrin ODA (fizikisht apo përmes emailit) dhe ajo duhet të kthehet e plotësuar dhe e nënshkruar më së largu deri më **1 tetor 2015**
- Nëse përzgjidheni si anëtar i grupit ju duhet **gjithsesi** të jeni të lirë të merrni pjesë në të gjitha sesionet e Grupit gjatë gjithë kohës si dhe për shfaqjen finale. Kërkesa për të qenë prezent gjatë gjitha sesioneve është e domosdoshme për shkak të natyrës së punës e cila kërkon pjesëmarrje të vazhdueshme.
- Grupet e Përhershme për Fëmijë të Teatrit ODA do të jenë një eksperiencë unike dhe mjaft argëtuese, por gjithashtu është edhe sfiduese. Ne presim një angazhim të lartë, pjesëmarrje të rregullt dhe të plotë, respektim me përpikëri të orarit dhe sjellje të pranueshme. Pjesëmarrësit që nuk i përmbahen këtyre kriterëve mund të përjashtohen nga grupi.
- Nga ju mund të kërkohet që të bëni detyra përgatitore për sesionin e radhës nga udhëheqësit e sesioneve, siç mund të jetë mësimi përmendësh i tekstit apo gjetja e ndonjë pike muzikore, materiali, kostumi apo rekuizite që duhet të sillni në sesionin e ardhshëm. Meqenëse sesionet kërkojnë angazhim si psikik ashtu edhe fizik ju këshillojmë që të mos planifikoni aktivitete tjera kohësisht afër sesioneve në mënyrë që të shmanget stërlodhja gjatë punës.
- Nëse keni nevoja speciale, ndonjë aftësi të kufizuar apo probleme shëndetësore që kërkojnë vëmendje gjatë kohës sa jeni në grup ju lutem kontaktoni Valon Ibraj në Teatrin ODA para fillimit të grupeve në telefonin 045 748 748 apo 038 246 555.

Dhe gjithsesi ...

Për ata që tregojnë përkushtim e angazhim të lartë, ne do t'i përzgjedhim për grupe tjera që do të organizojmë në Teatrin ODA në të ardhmen që përfshijnë edhe grupe që potencialisht mund të prodhojnë shfaqje teatrore apo edhe të marrin pjesë në shfaqje profesioniste të prodhuara nga Teatrit ODA. Vetë pjesëmarrja në Grupet e Përhershme për Fëmijë te Teatrit ODA nuk e garanton seleksionimin, por e jep mundësinë për një përzgjedhje të tillë në të ardhmen.

Grupet e Përhershme për Fëmijë të Teatrit ODA organizohet nga vet Teatri ODA me mundësitë dhe resurset vetanake.

Kontaktet

Për më shumë informacione ju mund të kontaktoni:

Valon Ibraj,

Teatri ODA,

Pallati i Rinisë, 111,

10030 Prishtinë,

KOSOVË

TEL: 038 246 555 / 045 748 748

Email: valoni@teatrioda.com, oda@teatrioda.com, teatrioda@gmail.com

www.teatrioda.com

<https://www.facebook.com/groups/teatrioda/>